



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 24.06.2025

Nr: 3462/___

NJËSIA E PROKURIMIT

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës – Sherbim

Objekti: Shërbimin e hostimit të faqes zyrtare të KQZ-se

Fondi limit: 8,119,870 (tetë million e njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) lekë pa tvsh.

Fondi është përlogaritur për një periudhë 24 mujore i ndarë në 3 vite buxhetore. Fondi për vitin 2025 fondi është 1,691,638, fondi për vitin 2026 është 4,059,936, fondi për vitin 2027 është 2,368,296

Procedura: E hapur e thjeshtuar, Sherbim

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): shërbimet e hostimit dhe operacionet e lidhura me te.

1.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të Vendimit nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar . Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vetetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të



vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Permbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:

Dëshmi të shërbimeve të mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit financiare, me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për të vërtetuar këtë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kur shërbimet e mëparshme të ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Kur shërbimet e mëparshme të ngjashme janë realizuar me subjekte private, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 gërma b) të Vendimit nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në të cilën është e përcaktuar se: *Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron, për 3 (tre) vitet e fundit financiar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43 pika 2 gërma c, të Vendimit nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”.* Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.



Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar, është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të Vendimit nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme¹”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet:

Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001 ose ekuivalente, ose i përditësuar (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO).

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesi Çertifikatë me standardet ISO 20000-1, për Menaxhimin e Shërbimeve TI dhe Qeverisja TI, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në emër të ofertuesit.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO).

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesi Çertifikatë me standardet ISO 27001 për Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit (të përkthyer dhe noterizuar), lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në emër të ofertuesit

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO).

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesi Çertifikatë me standardet ISO 22301 Business Continuity Management (të përkthyer dhe noterizuar), lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në emër të ofertuesit

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO).

Argumentim: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

¹ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021



“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...” Nisur nga rëndësia e mallrave, gjykohet e arsyeshme që operatori ekonomik të jetë i pajisur me certifikata të standardeve botërore, të cilat në mënyrë direkte ndikojnë në cilësi, e mallrave të ofruara.

Certifikata e standardit të cilësisë EN ISO 9001:2015 është sot referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë së kompanive të të gjithë sektorëve dhe të gjithë përmasave. Ky kriter kërkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi të kontratës objekt prokurimi, sipas standardeve ndërkombëtare. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, siguron që operatori ekonomik zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilësor të tij.

ISO 27001:2022 është një standard ndërkombëtar për menaxhimin e sigurisë së informacionit dhe ofron një standard të qartë të politikave dhe procedurave që organizatat duhet të ndjekin për të siguruar të dhënat e tyre dhe për të parandaluar humbje të të dhënave ose shkelje të sigurisë. Certifikimi sipas kërkesave të kriterit i siguron AK mbrojtjen e të dhënave, identifikimin e rrisqeve të sigurisë dhe në ndërmarrjen e masave për t’i parandaluar ato. Certifikata e menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001:2022 ose ekuivalente, është e nevojshme, për shkak të rëndësisë së veçantë që kanë modulet objekt prokurimi. Rrjedhimisht ISO 27001 (ose ekuivalente) është e nevojshme për AK për sigurinë dhe të dhënat dhe krijon besueshmëri në implementimin e kontratës.

Sistemi i menaxhimit të shërbimit është një kuadër standardizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomike për: ndjekjen konsistente të shërbimeve përgjatë afatit të zbatimit të kontratës, sipas kërkesave të DST-së. Standardi ISO 20000-1:2018 përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohen në teknologjitë e informacionit. Sistemi i menaxhimit të Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit siguron që operatori ekonomik ka të implementuar një sistem ofrimi të shërbimit përmes të cilit efektivisht planifikon, zhvillon, optimizon, operon, monitoron, kontrollon dhe mirëmban portofolin e shërbimeve dhe cilësinë e tyre.

3.2.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë të paktën personelin kryesor, si më poshtë:

3 (tre) specialistë të fushave të Inxhinierisë Elektronike/Informatike/Telekomunikacionit.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

a- Diplomën e studimeve universitare në këto fusha, (origjinale ose fotokopje të noterizuar).

b- Kontratën e punës (origjinale ose fotokopje të noterizuar).

c- Listëpagesat për 3 muajt e fundit.



Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me nenin 77 pika (4) të LPP, ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.” Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë që ka staf teknik të kualifikuar për realizimin e kontratës. Për këtë arsye, janë kërkuar specialistët sipas zërave të artikujve objekt i kësaj procedure për zgjidhjen e ofertuar. Të gjitha këto garantojnë Autoritetin Kontraktor se stafi teknik i Operatorit Ekonomik është i çertifikuar, ka njohuritë dhe ekspertizën e duhur profesionale për realizimin e kontratës, për zërat respektivë të objektit të prokurimit. Niveli i kërkuar profesional garanton profesionalizëm dhe njohuri teknike të avancuara për realizimin e kontratës. Numri i punonjësve të kërkuar është caktuar duke u bazuar në natyrën dhe numrin e shërbimeve, objekt prokurimi dhe proceset e punës, të cilat duhet të përmbushë ky shërbim.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2.3.6 Operatorit Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një propozim mbi realizimin e shërbimit, ku do të detajoj stafin që do të angazhohet (me kualifikimet dhe eksperiencën përkatëse) personin e kontaktit që të jetë drejtuesi i programit si dhe propozimet mbi realizimin e shërbimeve.

Argumentim : Propozimi është kërkuar për shkak të natyrës dhe rëndësisë që kanë delegacionet që do të vinë, AK duhet të sigurohet që OE do ta realizojë në kohë dhe sipas kërkesave të AK. Bazuar në pikën 6, neni 41 nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

3.Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Bazuar në pikën 2, neni 45 të vkm VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, *Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose koston, duke përdorur metodën e efektivitetit të koston, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kritereve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.*

A) ²Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

² Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë “oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë 20 pikë dhe propozimi teknik 80 pikë.



Sipas rëndësisë:

- çmimi 50 % pikët 50
- Oferta/Propozimi Teknik 20% pikët 20
- Organizimi, kualifikimin, përvoja e stafit që është emëruar për të zbatuar kontrantën 10% pikët 10
- Koha e përgjigjes në rast problematikash për zgjedhjen e kërkesës 10% pikët 10
- Koha e zgjedhjes së problemit 10% pikët 10

Bazuar në pikën 4, neni 45 të vkm VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në kontratat që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmban dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit/entit kontraktor shpenzime gjatë fazës së zbatimit të saj ose dhe më tej, kriteri i ofertës ekonomike është më të favorshme bazohet në:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij; dhe/ose

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; dhe/ose

c) shërbimin koston pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Në rastin kur, oferta ekonomike është më të favorshme identifikohet në bazë të koston, autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë, si dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

1. Çmimi [50] pikë Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij. Pikët për këtë kriter përllogariten sipas formulës: $Pk1 = \frac{Vmink1}{Ok1} \times Pmaxk1$ Pikët e kriterit që vlerësohet $Vmink1$ Vlera e më të ulët e kriterit që vlerësohet $Pmaxk1$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet 7 $Ok1$ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet
2. Oferta/Propozimi Teknik

Oferta/propozimi teknik që OE do të paraqesë është një pasqyre për AK se si OE do të realizojë shërbimet e hostimit, duke na siguruar besueshmëri në realizimin me sukses të kontratës.

3. Organizimi, kualifikimin dhe përvojën e stafit për të zbatuar kontrantën.

Ky kriter është vendosur duke mbajtur në konsideratë natyrën e objektit të procedurës... AK ka kërkuar një numër stafi të caktuar për marrjen e këtij shërbimi në të njëjtën kohë dhe më cilësi. Në bazë të kualifikimeve të stafit do të jetë dhe marrja e pikëve.

4. Koha e përgjigjes në rast problematikash për zgjedhjen e kërkesës.

Ky kriter është vendosur si pjesë e ofertës/ propozimit teknik të kërkuar. OE do të paraqesin propozim teknik për objektin e kërkuar. Në rast se OE në propozimin e tyre kanë një afat më të shkurtër në përgjigje do të marrë më shumë pikë.

5. Koha e zgjedhjes së problemit

Ky kriter është vendosur si pjesë e ofertës/ propozimit teknik të kërkuar. OE do të paraqesin propozim teknik për objektin e kërkuar. Në rast se OE në propozimin e tyre kanë një afat më të shkurtër zgjedhjen e problemit, duke nisur nga rëndësia që faqa web ku paraqet dhe rezultatet zgjedhore, sidomos në periudhë zgjedhore, sa më e shkurter të jetë koha aq më shumë pike do të marr OE.

4.SPECIFIKIMET TEKNIKE DHE FONDI LIMIT

Specifikimet teknike dhe Fondi Limit i kësaj procedure janë përcaktuar në bazë të materialit të grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike, referuar shkresës me nr. 3462/1 prot., datë 24.06.2025. Në zbatim të nenit 76 të Vendimit nr. 285, datë 19.5.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar me vendimin nr. 710, datë 24.11.2021), grupi i punës ka përllogaritur vlerën e prokurimit. Këto të dhëna jepen si më poshtë:

Llogaritja e vlerës së fondit limit është bazuar në parimet bazë të parashikimeve të nenit 34-35 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në bazë të përcaktimeve të nenit 12-13 dhe 76 të VKM-së nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), në të cilin është e përcaktuar se:

“Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

- a. *çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe*
- b. *studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe*
- c. *çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*

ç) *çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.*

Për llogaritjen e fondit limit të nevojshëm për këtë procedurë prokurimi, nga alternativat e lartpërmendura Grupi i punës u bazua tek pika: c. ***çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;***

Fondi limit i përllogaritur është **8,119,870.08 (tetë million e njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë pikë zero tetë lekë) pa TVSH.**

Njesia e Prokurimit



Procesverbal